BASHKIA KORÇE
NR 379 PROT
DATA 18/01/2023

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

**DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV**

Nr. 63/1 prot. Tiranë, më 17.01.2023

Lënda: Njoftim dhe kërkesë për informacion.

**BASHKISË KORÇË**
Rruga "28 Nëntori", Nr.1,
KORÇË

K. Bashkiak
NSHMAÇ

**KËSHILLIT BASHKIAK**
**BASHKIA KORÇË**
Rruga "28 Nëntori", Nr.1,
KORÇË

***Për dijeni:*** **Z. Daniel FRASHËRI**
Rruga "Xhefer Cenko Lubonja", Lagjja 8, pallati 8/4,
KORÇË

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"*, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 08, datë 11.01.2023, e z. Daniel Frashëri kundër Bashkisë Korçë dhe Këshillit Bashkiak Korçë, me pretendimin për diskriminim, për shkak të *racës*[1], *gjendjes ekonomike*[2] *dhe gjendjes civile*[3].

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: *"...Jam i divorcuar me dy fëmijë të cilët janë nën kujdestarinë time. Jetoj me nënën time e cila është e verbër dhe prej saj përfitoj pagesë kujdestarie. Jam i papunë dhe nuk marr ndihmë ekonomike sepse më kërkohet të regjistrohem si punëkërkues i papunë, ndërkohë që unë jam shoqërues i nënës time, gjë e cila më pengon që unë të punoj dhe të siguroj të ardhura të tjera në familje. Kam dy fëmijë të moshës 11 dhe 8 vjeç. Të dy fëmijët janë nxënës në shkollën 9 vjeçare "Asdreni". Mbështetur në VKM nr. 511, datë 27.7.2022, "Për përfitimin e bursave të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar", të ndryshuar, kam aplikuar pranë Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, Bashkia Korçë, duke dorëzuar të gjithë dokumentacionin përkatës dhe tani më thonë që nuk je*

[1] Referuar Vërtetimit Nr. 501 prot., datë 10.01.2023, të lëshuar nga Organizata "Unioni Egjiptianët e Shqipërisë", ankuesi i përket komunitetit egjiptian n137 Shqipëri.

[2] Referuar Vërtetimit të lëshuar nga Drejtoria e Kujdesit Social, Bashkia Korçë, datë 10.01.2023, ankuesi është kujdestari i shtetases D. F., me aftësi të kufizuara.

[3] Referuar Certifikatës Familjare datë 09.01.2023, ankuesi rezulton i divorcuar.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, E-mail: info@kmd.al, Web: www.kmd.al

*përfitues. Arsyen nuk e di. Ndërkohë që fëmijët e mi me vështirësi të madhe ekonomike i çoj në shkollë që të edukohen dhe të arsimohen. Po u drejtohem ju si institucion që të më zgjidhet problemi pasi shoh që kudo ku kam shkuar nuk më hapen dyert dhe më diskriminojnë duke mos më dhënë qoftë dhe një mundësi për të më shpjeguar arsyen. Listat janë miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak, i cili u mblodh në datë 28 dhjetor 2022".*

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit të tij nga ana e Bashkisë Korçë dhe Këshillit Bashkiak Korçë, për shkak të racës, gjendjes ekonomike dhe gjendjes civile, si dhe përfshirjen e fëmijëve të tij në listën e përfituesve të VKM-së Nr. 511, datë 27.7.2022 (e ndryshuar), *"Për përfitimin e bursave të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar".*

Përsa më lart, ju njoftojmë se Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi po ndjek të gjithë hapat e parashikuar në ligjin nr. 10 221/2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"*, të ndryshuar, për shqyrtimin e kësaj çështjeje.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221/2010, i ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *"Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër".*

Ligji 10221/2010, i ndryshuar, ka parashikuar në Nenin 7/1 se: *"Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim".*

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve, gëzon një mbrojtje të veçantë në kuadër të Kreut IV, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"*, të ndryshuar. Konkretisht në nenin 20, pikat 1 dhe 2, të po këtij ligji, përcaktohet se: *"1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato:*

*a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;*
*b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.*

*2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për: ......*

*c) kontributin dhe mundësinë për të përfituar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun..."*

Bazuar në ligjin 10221/2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"*, i ndryshuar, neni 32/2 *"Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacionin në përmbushjen e detyrave të tij"*, **kërkojmë nga ana juaj që të paraqisni parashtrime me shkrim mbi pretendimet e subjektit ankues, si dhe informacion dhe kopje dokumentacioni, sa më poshtë:**

- Informacion nga ana e Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak Korçë, lidhur me situatën e pretenduar nga ana e ankuesit.
- Informacion përse fëmijët e subjektit ankues nuk kanë përfituar nga parashikimet e VKM-së Nr. 511, datë 27.7.2022, *"Për përfitimin e bursave të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar"*, të ndryshuar.
- Informacion lidhur me numrin e fëmijëve që kanë përfituar nga parashikimet e VKM-së Nr. 511, datë 27.7.2022, *"Për përfitimin e bursave të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar"*, të ndryshuar, duke specifikuar kriterin për të cilin kanë përfituar, për secilin rast.

Si dhe çdo shpjegim apo informacion tjetër që ju do e gjykoni të arsyeshëm dhe do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështjeje.

Duke besuar në bashkëpunimin tuaj, sa më sipër është kërkuar, duhet të depozitohet pranë KMD-së, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pune nga marrja dijeni për këtë shkresë.

**KOMISIONERI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONER PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
TIRANË

**Robert GAJDA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**
**DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV**

Nr. 63/1 prot. Tiranë, më 17.01.2023

Lënda: Njoftim dhe kërkesë për informacion.

**BASHKISË KORÇË**
Rruga "28 Nëntori", Nr.1,
KORÇË

**KËSHILLIT BASHKIAK**
**BASHKIA KORÇË**
Rruga "28 Nëntori", Nr.1,
KORÇË

***Për dijeni:*** **Z. Daniel FRASHËRI**
Rruga "Xhefer Cenko Lubonja", Lagjja 8, pallati 8/4,
KORÇË

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"*, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 08, datë 11.01.2023, e z. Daniel Frashëri kundër Bashkisë Korçë dhe Këshillit Bashkiak Korçë, me pretendimin për diskriminim, për shkak të *racës*[1], *gjendjes ekonomike*[2] *dhe gjendjes civile*[3].

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: *"...Jam i divorcuar me dy fëmijë të cilët janë nën kujdestarinë time. Jetoj me nënën time e cila është e verbër dhe prej saj përfitoj pagesë kujdestarie. Jam i papunë dhe nuk marr ndihmë ekonomike sepse më kërkohet të regjistrohem si punëkërkues i papunë, ndërkohë që unë jam shoqërues i nënës time, gjë e cila më pengon që unë të punoj dhe të siguroj të ardhura të tjera në familje. Kam dy fëmijë të moshës 11 dhe 8 vjeç. Të dy fëmijët janë nxënës në shkollën 9 vjeçare "Asdreni". Mbështetur në VKM nr. 511, datë 27.7.2022, "Për përfitimin e bursave të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar", të ndryshuar, kam aplikuar pranë Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, Bashkia Korçë, duke dorëzuar të gjithë dokumentacionin përkatës dhe tani më thonë që nuk je*

[1] Referuar Vërtetimit Nr. 501 prot., datë 10.01.2023, të lëshuar nga Organizata "Unioni Egjiptianët e Shqipërisë", ankuesi i përket komunitetit egjiptian n137 Shqipëri.
[2] Referuar Vërtetimit të lëshuar nga Drejtoria e Kujdesit Social, Bashkia Korçë, datë 10.01.2023, ankuesi është kujdestari i shtetases D. F., me aftësi të kufizuara.
[3] Referuar Certifikatës Familjare datë 09.01.2023, ankuesi rezulton i divorcuar.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, E-mail: info@kmd.al, Web: www.kmd.al

*përfitues. Arsyen nuk e di. Ndërkohë që fëmijët e mi me vështirësi të madhe ekonomike i çoj në shkollë që të edukohen dhe të arsimohen. Po u drejtohem ju si institucion që të më zgjidhet problemi pasi shoh që kudo ku kam shkuar nuk më hapen dyert dhe më diskriminojnë duke mos më dhënë qoftë dhe një mundësi për të më shpjeguar arsyen. Listat janë miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak, i cili u mblodh në datë 28 dhjetor 2022".*

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit të tij nga ana e Bashkisë Korçë dhe Këshillit Bashkiak Korçë, për shkak të racës, gjendjes ekonomike dhe gjendjes civile, si dhe përfshirjen e fëmijëve të tij në listën e përfituesve të VKM-së Nr. 511, datë 27.7.2022 (e ndryshuar), *"Për përfitimin e bursave të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar"*.

Përsa më lart, ju njoftojmë se Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi po ndjek të gjithë hapat e parashikuar në ligjin nr. 10 221/2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"*, të ndryshuar, për shqyrtimin e kësaj çështjeje.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221/2010, i ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *"Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër"*.

Ligji 10221/2010, i ndryshuar, ka parashikuar në Nenin 7/1 se: *"Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim"*.

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve, gëzon një mbrojtje të veçantë në kuadër të Kreut IV, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"*, të ndryshuar. Konkretisht në nenin 20, pikat 1 dhe 2, të po këtij ligji, përcaktohet se: *"1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato:*

*a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;*
*b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.*

*2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për: ......*

*c) kontributin dhe mundësinë për të përfituar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun..."*

Bazuar në ligjin 10221/2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"*, i ndryshuar, neni 32/2 *"Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacionin në përmbushjen e detyrave të tij"*, **kërkojmë nga ana juaj që të paraqisni parashtrime me shkrim mbi pretendimet e subjektit ankues, si dhe informacion dhe kopje dokumentacioni, sa më poshtë:**

- Informacion nga ana e Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak Korçë, lidhur me situatën e pretenduar nga ana e ankuesit.
- Informacion përse fëmijët e subjektit ankues nuk kanë përfituar nga parashikimet e VKM-së Nr. 511, datë 27.7.2022, *"Për përfitimin e bursave të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar"*, të ndryshuar.
- Informacion lidhur me numrin e fëmijëve që kanë përfituar nga parashikimet e VKM-së Nr. 511, datë 27.7.2022, *"Për përfitimin e bursave të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar"*, të ndryshuar, duke specifikuar kriterin për të cilin kanë përfituar, për secilin rast.

Si dhe çdo shpjegim apo informacion tjetër që ju do e gjykoni të arsyeshëm dhe do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështjeje.

Duke besuar në bashkëpunimin tuaj, sa më sipër është kërkuar, duhet të depozitohet pranë KMD-së, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pune nga marrja dijeni për këtë shkresë.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË KOMISIONER PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI TIRANË